

The logo for the Central Bank of the Republic of Kosovo (BQK) is displayed in a bold, gold-colored font. The background of the entire cover features a blue and gold geometric design with a map of Kosovo and a cityscape at night.

BQK

BANKA QENDRORE E REPUKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKA KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

ANKETA E KREDITIMIT BANKAR NË KOSOVË

Numër 27

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

(TM1 2026 dhe pritjet për TM2 2026)

Numër 27

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Stabilitetit Financiar,
Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike

Luan Haradinaj 2, Prishtinë 10000

Tel: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Hyrje	5
Përmbledhje.....	6
1.0. Kreditë ndaj ndërmarrjeve	7
1.1. Standardet kreditore	7
1.2. Kushtet dhe rregullat.....	8
1.3. Kërkesa për kredi	9
1.4. Cilësia kreditore	10
2.0. Kreditë ndaj ekonomive familjare	10
2.1. Standardet kreditore	10
2.2. Kushtet dhe rregullat.....	11
2.3. Kërkesa për kredi	11
2.4. Cilësia kreditore	12
3.0. Financimi	12
3.1. Përmbledhje e pyetjeve të fokusuara	13
4.0. Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit.....	14
Kutia 1. Metodologjia	15
Pritjet për inflacionin	16

Shkurtesat

AKBK – Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

FKGK – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

NVM- Ndërmarrjet e vogla të mesme

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

Hyrje¹

Me qëllim parësor thellimin e kuptimit të dinamikave të kreditimit në Kosovë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) realizon anketë periodike me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Si qëllim dytësor, anketa vlerëson pritjet e sektorit bankar lidhur me zhvillimet në nivelin e çmimeve të konsumit (inflacionit) në vend.

Raporti tremujor, që analizon rezultatet e këtij anketimi, ofron pasqyrë të gjerë dhe sistematike mbi perceptimin e rrezikut dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe mbi sjelljen e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve ndaj ndryshimeve në kushtet e kreditimit. Përveç pyetjeve standarde, anketa përfshinë edhe pyetje shtesë, të cilat sigurojnë informacion kualitativ për shpjegimin e dinamikave aktuale në sektorin bankar, si dhe për zbërthimin e zhvillimeve të ofertës dhe kërkesës kreditore për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik.

Ky edicion i raportit pasqyron sjelljen kreditore për tremujorin e parë të vitit 2026, si dhe pritjet e bankave për dinamikat e kreditimit dhe inflacionin në tremujorin e dytë të vitit 2026.

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

Përmbledhje

Rezultatet e anketës për tremujorin e parë të vitit 2026 tregojnë se oferta kreditore ishte kryesisht e pandryshuar, si për ekonomitë familjare, ashtu edhe ndërmarrjet. Po ashtu, edhe kërkesa kreditore në përgjithësi mbeti e pandryshuar, por me tendencë rënëse për kreditë konsumuese/ personale në segmentin e ekonomive familjare, si dhe për ndërmarrjet e mëdha. Për tremujorin vijues (TM2 2026), bankat presin që standardet kreditore të mbeten kryesisht të pandryshuara si për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, ndërsa kërkesa për kredi pritet të jetë dukshëm më e lartë për të dyja kategoritë.

Për segmentin e ndërmarrjeve, **standardet kreditore** në TM1 2026 mbetën kryesisht të pandryshuara, ngjashëm me tremujorin paraprak, si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Faktorët përcaktues ishin konkurrenca, pozicioni me likuiditet, qasja në burimet e përgjithshme të financimit, si dhe perceptimi mbi perspektivën e tregut vendor. **Në kuadër të kushteve dhe rregullave të ofruara**, bankat deklaruan shtrëngim deri në një masë vetëm në normën e ofruar të interesit, si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Ndërsa, kushtet dhe rregullat tjera të kreditimit - maturiteti i kredive, madhësia e kredisë dhe tarifat tjera - mbetën kryesisht të pandryshuara. **Niveli i aprovimit** të kredive ka shënuar rritje për të dytin tremujor me radhë. **Kërkesa për kredi** mbeti kryesisht e pandryshuar me tendencë rënëse për segmentin e ndërmarrjeve të mëdha, kryesisht rezultat i kërkesës më të dobët për financim të inventarit-kapitalit punues dhe investimeve fikse. **Cilësia e kredive** shënoi rënie gjatë këtij tremujori, me pritje për dinamikë të ngjashme edhe në tremujorin vijues. Për TM2 2026, bankat presin që standardet kreditore të mbeten kryesisht të pandryshuara, kurse kërkesa kreditore pritet të rritet konsiderueshëm, në veçanti për NVM-të. Kushtet dhe rregullat e aplikuara kryesisht pritet të mbesin të ngjashme me tremujorin aktual.

Për segmentin e ekonomive familjare, **standardet kreditore** mbetën kryesisht të pandryshuara, pas shtrëngimit të evidentuar për tre tremujorë radhazi, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për ato personale/konsumuese. Faktorët kryesorë që përcaktuan standardet kreditore gjatë këtij tremujori ishin pozita e favorshme e likuiditetit, cilësia e mirë e portfolios kreditore dhe konkurrenca ndërbankare. Po ashtu, **kushtet dhe rregullat e ofruara** mbeten në përgjithësi të pandryshuara, me përjashtim të normës së interesit e cila u shtrëngua lehtësisht për kreditë për blerje të shtëpive, ndërsa shënoi rënie të lehtë për kreditë konsumuese. **Niveli i aprovimit** të kredive shënoi rritje të lehtë, megjithatë dukshëm më të ulët krahasuar me tremujorin paraprak. **Kërkesa për kredi** mbeti përgjithësisht e pandryshuar, me tendencë të lehtë rënëse për kreditë personale/konsumuese, ndikuar kryesisht nga rënia e kërkesës për financim të shpenzimeve të tjera për konsum. **Cilësia e kredive** u përmirësua nga tremujori paraprak, ndërsa për tremujorin në vijim pritet të mbetet e pandryshuar - me tendencë të lehtë rënëse. Për TM2 2026, standardet kreditore pritet të mbesin të pandryshuara në përgjithësi, ndërsa kërkesa për kredi pritet të shënoj rritje deri në një masë në përgjithësi, me rritje pak më të theksuar për kreditë për blerje të shtëpive (tabela 1).

Qasja e bankave në financim shënoi rritje të lehtë, e mbështetur kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, ndërsa depozitat e korporatave jofinanciare shënuan rënie të lehtë krahasuar me tremujorin paraprak. Gjithashtu, financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare shënoi rritje deri në një masë. Në tremujorin në vijim, qasja në financim pritet të rritet tutje, e mbështetur kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe financimi brenda grupit, ndërsa kontribut më të ulët pritet të kenë depozitat nga korporatat jofinanciare.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore.

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM1 2026	TM2 2026 (pritjet)	TM1 2026	TM2 2026 (pritjet)
Ndërmarrjet	➡	➡	➡	⬆
NVM	➡	➡	➡	⬆
Ndërmarrjet e mëdha	➡	➡	➡	➡
Ekonomitë familjare	➡	➡	➡	⬆
Kredi për blerjen e shtëpive	➡	➡	➡	⬆
Kredi konsumuese	➡	➡	➡	➡
⬆ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20) ➡ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20) ➡ Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05) ➡ Shtrëngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20) ⬇ Shtrëngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)				


Burimi: BQK.

1.0. Kreditë ndaj ndërmarrjeve

1.1. Standardet kreditore

Rezultatet e mesatarizuara² të Anketës së Bankave për TM1 2026 tregojnë se standardet kreditore për segmentin e ndërmarrjeve mbetën kryesisht të pandryshuara, ngjashëm me tremujorin paraprak (Grafiku 1). Ky trend u evidentua si te NVM-të ashtu edhe te ndërmarrjet e mëdha, duke shënuar stabilitet për tremujorin e dytë me radhë.


Grafiku 1. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Shumica e faktorëve me ndikim në standardet kreditore mbetën kryesisht të pandryshuar, përfshirë konkurrencën, qasjen në burimet e përgjithshme të financimit, pozicionin me likuiditet, si dhe perceptimin mbi perspektivën e tregut vendor. Ndërkaq, faktor i vetëm i listuar me ndikim shtrëngues në standardet kreditore ishte toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut, e cila u neutralizua nga faktorët lehtësues, ku peshën më të larët e kishte mbështetja e vazhdueshme nga FKKG (Grafiku 2).

² Reflektojnë mesataren e peshuar në kreditim të secilës bankë.


Grafik 2. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet

Burimi: BQK.

Për TM2 2026, bankat presin që standardet kreditore për sektorin e ndërmarrjeve të mbeten kryesisht të pandryshuara, trend që pritet të vazhdojë për të tretin tremujorë me radhë. Efekt pozitiv pritet të ketë mbështetja nga FKGGK, ndërsa efekt negativ pritet të ketë toleranca më e ulët për ndërmarrje rreziku, por këto efekte priten të neutralizohen nga faktorët tjerë (Grafik 2).

1.2. Kushtet dhe rregullat

Në TM1 2026, kushtet dhe rregullat e kreditimit për ndërmarrjet mbeten të shtrënguara vetëm në komponentën e normës së interesit (Grafiku 3). Konkretisht, bankat raportuan rritje të normës së interesit për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha, duke vazhduar trendin shtrëngues për të pestin tremujorë me radhë. Në këtë tremujor u evidentua lehtësim në kërkesat për kolateral, ndryshe nga periudha paraprake kur ato mbetën të pandryshuara. Ndërkaq, elementet e tjera të kushteve të kreditimit – si maturiteti i kredive, madhësia e kredisë dhe tarifat e tjera – mbetën kryesisht të pandryshuara.

Grafik 3. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ndërmarrjet

Burimi: BQK.


Faktorët që ndikuan në kushtet dhe rregullat e kreditimit për segmentin e ndërmarrjeve, veçanërisht në drejtim të shtrëngimit të normave të interesit, lidhen kryesisht me qasjen në burimet e përgjithshme të financimit dhe me uljen e tolerancës së bankave ndaj rrezikut, megjithëse kjo e fundit kishte ndikim dukshëm më të ulët. Nga ana tjetër, mbështetja e vazhdueshme nga FKGGK-ja vazhdon të kontribuojë në zbutjen, përkatësisht lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat, e evidentuar kryesisht në lehtësimin e kërkesave për kolateral. Në tremujorin vijues, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritët të mbesin kryesisht të pandryshuara.

Në TM1 2026, niveli i aprovimit të kredive për ndërmarrjet shënoi rritje. Konkretisht kishte nivel më të lartë të aprovimeve për kreditë për NVM-të, si për kreditë me maturitet afatshkurtër ashtu edhe ato afatgjatë. Për tremujorin vijues, niveli i aprovimit pritët të rritet konsiderueshëm për të dy segmentet, e në veçanti për NVM-të për kreditë e të gjitha maturiteteve.

1.3. Kërkesa për kredi

Sipas rezultateve të anketës, në TM1 2026 kërkesa për kredi nga ndërmarrjet në përgjithësi mbeti e pandryshuar, ndërsa u evidentua tendencë rënëse për ndërmarrjet e mëdha, kryesisht për kreditë me maturitet afatshkurtër. Për NVM-të, bankat deklaruan kërkesë kryesisht të pandryshuar, veçanërisht për kreditë me maturitet afatgjatë (Grafiku 4).

Grafiku 4. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Për dallim nga tremujori paraprak, kur kishte kërkesë dukshëm më të lartë për investime fikse, inventar dhe kapital punues, gjatë këtij tremujori vërehet kërkesë dukshëm më e ulët për këto qëllime, si dhe rënie e kërkesës për ristrukturim të borxhit, për herë të parë që nga TM4 2024 (Grafiku 5).

Cilësia e aplikacioneve të pranura nga ndërmarrjet mbeti kryesisht e pandryshuar në këtë tremujor, *por pritjet të përmirësohet lehtësisht në TM2 2026*.

Grafik 5. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Në TM2 2026, bankat presin rritje të dukshme të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, me theks të veçantë te NVM-të. Rritje e kërkesës pritjet në të gjitha segmentet e maturitetit. Faktorët me ndikim në këtë dinamikë do të jenë kryesisht nevojat për financimin e inventarit dhe kapitalit punues, pasuar nga kërkesa po ashtu e lartë për financimin e investimeve fikse.

1.4. Cilësia kreditore


Bankat në përgjithësi raportuan për rritje të ulët të kredive joperformuese për segmentin e ndërmarrjeve, trend ky që pritet të vazhdojë edhe në *TM2 2026*.

2.0. Kreditë ndaj ekonomive familjare

2.1. Standardet kreditore

Bazuar në rezultatet e Anketës së Kreditimit për TM1 2026, standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare mbeten të pandryshuar në përgjithësi, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për kreditë personale/konsumuese (Grafiku 6). Ky zhvillim për segmentin e ekonomive familjare është në linjë me pritjet e bankave nga tremujori paraprak dhe njëkohësisht shënoi ndërprerjen e trendit të shtrëngimit të standardeve kreditore të evidentuar gjatë tre tremujorëve paraprakë.


Grafiku 6. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që përcaktuan standardet kreditore gjatë këtij tremujori ishin pozita e favorshme e likuiditetit, cilësia e mirë e portfolios kreditore, si dhe konkurrenca ndërbankare (Grafiku 7).

Grafik 7. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Për *TM2 2026*, standardet kreditore për ekonomitë familjare pritjet të mbesin të pandryshuara në përgjithësi, si për kreditë personale/konsumuese ashtu edhe për kreditë për blerje të shtëpive. Këto pritje janë të ndikuara kryesisht nga perspektiva e tregut vendor, ndërsa pozita e likuiditetit, konkurrenca ndërbankare dhe kualiteti i portfolios kreditore pritjet të ndikojë në një masë dukshëm më të kufizuar.

2.2. Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare mbeten kryesisht të pandryshuara për të dy segmentet: kreditë për blerje të shtëpive si dhe ato personale/konsumuese (Grafiku 8). Më konkretisht, në kuadër të kushteve dhe rregullave bankat raportuan shtrëngim të lehtë të normës së interesit për kreditë për blerje të shtëpive, ndërsa për kreditë personale/konsumuese u deklarua lehtësim marginal i normës së interesit. Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga qasja në financim dhe perspektiva e tregut vendor, të cilat ushtruan presion në kahun shtrëngues, ndërsa pozita e favorshme e likuiditetit kontribuoi në lehtësimin e kushteve të kreditimit.

Grafik 8. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Për TM2 2026, bankat presin lehtësim në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare. Më konkretisht, pritet lehtësim i normës së interesit si për kreditë për blerje të shtëpive, ashtu edhe për kreditë personale/konsumuese, ndikuar kryesisht nga perspektiva e tregut vendor dhe e bankave. Ndërkohë, kushtet dhe rregullat e tjera të kreditimit pritet të mbeten kryesisht të pandryshuara.


Niveli i aprovimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare shënoi rritje të lehtë, por dukshëm më të ulët se tremujorin paraprak. Për tremujorin e dytë të vitit 2026, niveli i aprovimit pritet të rritet lehtë për ekonomitë familjare në përgjithësi, veçanërisht për kreditë për blerje të shtëpive, me maturitet afatgjatë.

2.3. Kërkesa për kredi

Bazuar në rezultatet e anketës për TM1 2026, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare mbeti e pandryshuar në përgjithësi, me tendencë të lehtë rënësë për kreditë personale/konsumuese (Grafiku 9). Në anën tjetër, kërkesa për kreditë për blerje të shtëpive mbeti pothuajse e pandryshuar nga tremujori paraprak, me lëvizje të lehtë në kahun pozitiv.

Faktorët kryesorë që ndikuan kërkesën e përgjithshme për kredi nga ekonomitë familjare ishin rënia e shpenzimeve për konsum nga tremujori i fundit i vitit, i cili zakonisht karakterizohet me rritje të këtyre shpenzimeve, si dhe në një masë më të vogël rënia e konfidencës së konsumatorit (Grafiku 10). Për TM2 2026, kërkesa kreditore e ekonomive familjare pritet të rritet deri në një masë në përgjithësi, me shcallë më të theksuar në segmentin e kredive për blerje të shtëpive dhe kredive afatgjata, krahasuar me kreditë konsumuese dhe ato afatshkurta.


Grafik 9. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare, ngjashëm me tremujorin paraprak, ka mbetur e pandryshuar, *dinamikë e cila pritjet të vazhdoj edhe në tremujorin e dytë të vitit 2026.*

Grafik 10. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


2.4. Cilësia kreditore

Në tremujorin e parë të vitit 2026, bankat raportuan përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore për segmentin e ekonomive familjare, përkatësisht rënie të lehtë të nivelit të kredive joperformuese nga tremujori i kaluar. *Për TM2 2026, ky tregues pritjet të mbetet kryesisht i pandryshuar, përkundër tendencës të lehtë rritëse.*

3.0. Financimi

Në TM1 2026, qasja në financim e bankave ka shënuar rritje të lehtë, mbështetur kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare. Në anën tjetër, depozitat e korporatave jofinanciare u karakterizuan me rënie krahasuar me tremujorin paraprak. Financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare shënoi rritje deri në një masë gjatë këtij tremujori, ndërsa financimi brenda grupit mbeti kryesisht i pandryshuar. Sa i përket maturitetit, financimi afatshkurtër shënoi rritje të konsiderueshme, ndërsa ai afatgjatë ishte me tendencë të lehtë rënës (Grafiku 11).

Grafik 11. Ndryshimi në financimin e e sektorit bankar



Burimi: BQK.

Në tremujorin në vijim, qasja në financim pritet të përmirësohet më tej, e mbështetur kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe financimi brenda grupit, ndërsa kontribut më të ulët pritet të kenë depozitat nga korporatat jofinanciare.

3.1. Përmbledhje e pyetjeve të fokusuara

Pyetësi i anketës për TM1 2026 është plotësuar me dy pyetje shtesë, të cilat kanë për qëllim zgjerimin e përmbajtjes së anketës përtej pyetjeve standarde që lidhen me ofertën dhe kërkesën kreditore dhe faktorët ndikues mbi to. Në këtë edicion, bankat janë pyetur lidhur me rreziqet kryesore ndaj të cilave janë të ekspozuara dhe ndikimin e pritshëm në aktivitetin e tyre, si dhe mbi ndikimin e presioneve aktuale inflacioniste në politikat dhe standardet kreditore.

Në përgjigjet e dhëna rreth pyetjes së parë, në përgjithësi bankat identifikuan rrezikun kreditor - veçanërisht mundësinë e rritjes së kredive joperformuese dhe dobësimin e aftësisë paguese të klientëve - si rrezikun kryesor për perspektivën e aktivitetit bankar. Faktorët që bankat perceptuan se kontribuojnë në rritjen e këtyre rreziqeve përfshijnë presionet inflacioniste, rritjen e kostove të energjisë dhe ushqimit, ngadalësimin e mundshëm të aktivitetit ekonomik, tensionet gjeopolitike dhe ritmin e shpejtë të rritjes së kreditimit. Megjithatë, duke marrë parasysh peshën më të madhe të bankave që nuk raportojnë rreziqe specifike të menjëhershme ose i vlerësuan ato si të menaxhueshme, perceptimi i përgjithshëm për rrezikun në sistemin bankar mbetet relativisht i ulët dhe i kontrollueshëm.

Në përgjigjet e dhëna lidhur me pyetjen e dytë, konkretisht ndikimit të inflacionit në politikat dhe standardet e kreditimit, bankat përgjithësisht nuk raportojnë ndryshime të theksuara në kriteret formale të kreditimit. Megjithatë, presionet inflacioniste po reflektohen në mënyrë indirekte përmes vlerësimit më të kujdesshëm të aftësisë paguese, rrjedhjes së parasë, kostove operative të bizneseve, fuqisë blerëse të ekonomive familjare, normave të interesit dhe vlerësimit të kolateralit. Në këtë fazë, ndikimi i inflacionit u perceptua më shumë si faktor monitorimi dhe kujdesi në procesin kreditor, se sa si shtrëngim i përgjithshëm i standardeve të kreditimit.

Sa i përket përgjigjeve të disagreguara të bankave për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik, standardet kreditore si dhe kushtet dhe rregullat e aplikuara janë në një linjë me deklaratimet për ndërmarrjet në përgjithësi për këtë tremujor, me përjashtim të vlerësimit për segmentin e ndërtimit dhe të patundshmërisë, për të cilët bankat deklaruan shtrëngim të standardeve kreditore dhe kushteve dhe rregullave të aplikuara. Për më tepër, edhe kërkesa për kredi u raportua me rënie për segmentin e ndërtimit. Për segmentin e prodhimit kishte lehtësim të standardeve kreditore, kurse shërbimet dhe tregtia nuk kishin ndryshim. Kërkesë gjithashtu ishte e pandryshuar për segmentin e shërbimeve, kurse segmenti i tregtisë kishte kërkesë më të lartë.

Në tremujorin vijues, standardet kreditore, kushtet dhe rregullat pritjet të mbeten kryesisht të ngjashme me tremujorin aktual, me standarde kreditore më të shtrënguara për segmentin e ndërtimit në veçanti dhe atë të patundshmërive, kurse kërkesa do të jetë e lartë për të gjitha veprimtaritë ekonomike.

4.0. Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit

Sipas anketës së realizuar në prill 2026, bankat komerciale presin që inflacioni të mbetet në nivele të larta edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, megjithëse me një moderim të lehtë krahasuar me tremujorin paraprak. Sipas vlerësimeve të tyre, norma e inflacionit pritjet të jetë 6.1 përqind në TM2 2026, nga 6.2 përqind në tremujorin paraprak, bazuar në të dhënat preliminare të ASK-së, ndërkohë që të dhënat e reviduara për TM1 2026 tregojnë një normë inflacioni prej 6.0 përqind, duke sinjalizuar se bankat presin një zbutje graduale të presioneve inflacioniste në periudhën afatshkurtër. Megjithatë, bankat kanë rritur ndjeshëm pritjet për inflacionin mesatar vjetor për vitin 2026 në 5.6 përqind, krahasuar me 4.2 përqind sa prisnin në anketën e tremujorit paraprak (Tabela 2).


Tabela 2. Pritjet e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM1 2026	TM2 2026	2026
1	6.0%	6.0%	5.5%
2	6.2%	5.6%	3.6%
3	4.9%	4.9%	4.7%
4	6.7%	6.4%	5.9%
5	6.7%	7.3%	6.8%
6	6.7%	7.0%	6.5%
7	6.7%	6.8%	6.1%
8	6.2%	4.9%	5.1%
9	6.0%	5.6%	5.9%
10	5.8%	6.0%	6.0%
Mesatarja	6.2%	6.1%	5.6%

Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulumet e BQK-së.

Grafiku 12 paraqet vlerësimin e bankave mbi probabilitetin e realizimit të niveleve të ndryshme të inflacionit në tremujorin e ardhshëm. Krahasuar me anketën e TM4 2025, pritjet janë zhvendosur më tej drejt intervaleve më të larta të inflacionit, duke reflektuar rritjen e pasigurive dhe perceptimit për rreziqe në kahun rritës. Derisa më herët pritjet ishin të përqendruara kryesisht në intervalet 4.0–5.9 përqind, rezultatet e anketës së prillit tregojnë se bankat vlerësojnë probabilitet më të lartë për realizimin e normave më të larta të inflacionit gjatë vitit 2026, me pritjet e përqendruara në intervalin 6.0-6.9 përqind, madje me probabilitet edhe për rritje mbi 7.0 përqind sipas disa bankave. Kjo zhvendosje është në përputhje me ecurinë e IHÇK i cili rezultoi 7.5 përqind në prill 2026.

Grafik 12. Probabiliteti i inflacionit për tremujorin e ardhshëm (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulumet e BQK-së.

Sipas bankave, presionet inflacioniste pritjet të mbeten të pranishme përgjatë vitit 2026, të nxitura kryesisht nga niveli i lartë i çmimeve të energjisë, transportit dhe ushqimit, si pasojë e ekspozimit të ekonomisë ndaj zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare dhe varësisë nga importi. Në veçanti, rritja e çmimeve të karburanteve dhe kostove të transportit, e kombinuar me pasiguritë që burojnë nga tensionet gjeopolitike, vazhdon të ushtrojë presione në kahun rritës të inflacionit.

Në përgjithësi, bankat parashikojnë një ngadalësim të lehtë të inflacionit në tremujorin e dytë të vitit 2026, pavarësisht qëndrueshmërisë së presioneve inflacioniste. Në të njëjtën kohë, pritjet për një inflacion mesatar vjetor prej 5.6 përqind sinjalizojnë se niveli i çmimeve do të mbetet mbi atë të vitit 2025, por me një trajektore gradualisht zbutëse gjatë vitit 2026. Megjithatë, presionet afatshkurtra vazhdojnë të jenë të pranishme dhe përcaktuese për dinamikën e përgjithshme të çmimeve, duke përfshirë pasiguritë e jashtme dhe qëndrueshmërinë e presioneve të çmimeve që vazhdojnë të paraqesin rreziqe në kahun rritës të inflacionit.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetësi i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë personale/konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritjet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen. Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga dhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.1 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar. Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

Pritjet për inflacionin

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore. Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e madhe për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestritimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, shërbejnë gjithashtu si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse publiku beson se banka qendrore do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të arritur objektivin e inflacionit, atëherë pritjet e agjentëve ekonomik për shkallën e inflacionit do të jenë më të afërta me objektivin e përcaktuar.

Pritjet e inflacionit janë gjithashtu të rëndësishme për bankat që nuk posedojnë politikë monetare, pasi ato shërbejnë si input i rëndësishëm për përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe për procesin e modelimit dhe parashikimit ekonomik. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, e cila më pas ndikon në ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual, i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Një prej metodave më të përdorura është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore dhe shoqërohen me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore: fillimisht për tremujorin aktual, pastaj për tremujorin e ardhshëm dhe për vitin në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit të të dhënave për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

